



***STRATEGJIA E MBROJTJES  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT***

Mars 2020, Shkup

## PËRMBAJTJA

|  |                                     |
|--|-------------------------------------|
| I. HYRJA.....  | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |
| II. RETHIMI I SIGURT .....                             | 5                                   |
| III. KËRCËNIMET, RREZIQET DHE SFIDAT E MBROJTJES ..... | 9                                   |
| IV. POLITIKA E MBROJTJES .....                         | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |
| V. SISTEMI I MBROJTJES.....                            | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |
| VI. BURIMET DHE AFTËSITË E MBROJTJES                   |                                     |
| VII. ZBATIMI   |                                     |
| VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....                    | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |

Në pajtim me nenin 18, paragrafi 1, pika 1 të Ligjit të Mbrojtjes (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/01, 05/03, 58/06, 110/08, 51/11, 151/11 dhe 215/15 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/20), kryetari i Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

## STRATEGJINË E MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

### I. HYRJA

1. Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ofron udhëzime strategjike të funksionimit dhe zhvillimit të sistemit të mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Strategjia buron nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, angazhimet e përhershme nga Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe i Mbrojtjes, Ligji i Mbrojtjes dhe Angazhimi Strategjik i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Integrim, në strukturat euroatlantike.
3. Të udhëhequr nga ndryshimet në rrethin e sigurt, si dhe sfidat, kërcënimet dhe rreziqet e reja të sigurisë, ne kemi filluar të zhvillojmë strategji të re. E njëjta i identifikon tiparet kryesore të rrethit të sigurt, e thekson politikën tonë të mbrojtjes dhe nxjerr udhëzime të përshtatjes së subjekteve të sistemit të mbrojtjes, burimet e nevojshme dhe aftësitë mbrojtëse të nevojshme të realizimit të saj.
4. Në pajtim me detyrimet dhe përgjegjësitë që do të rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në sistemet e sigurisë kolektive, strategjia ka si qëllim:
  - rritjen e rezistencës së sistemit në përballjen e rreziqeve dhe kërcënimeve;
  - përmirësimin e aftësive ekzistuese dhe zhvillimin e aftësive të reja që janë të nevojshme për funksionimin efektiv dhe efikas të sistemit;
  - sigurimin e transparencës më të madhe ndërmjet të gjitha subjekteve dhe përgjegjësisë në mbrojtjen e interesave të mbrojtjes dhe në realizimin e qëllimeve të mbrojtjes;
  - sinkronizimin dhe përmirësimin e planifikimit të mbrojtës në pajtim me standardet e NATO-s dhe të BE-së;

- efikasitetin më të madh dhe shfrytëzimin racional të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare;
- rritjen e ndërgjegjësimit dhe besimin e popullatës së rëndësisë së sistemit të mbrojtës, në zhvillimin e shoqërisë demokratike;

5. Strategjia paraqet bazë të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes dhe përmirësimin e procesit të planifikimit afatgjatë të mbrojtjes.

## II. RRETHIMI I SIGURT

### Niveli global

6. Mjedisi bashkëkohor i sigurisë globale më së miri mund të karakterizohet si i paparashikueshëm dhe kompleks. Zhvillimi i shpejtë dhe dinamik social, politik, ekonomik, teknologjik dhe ndryshimet në balancën e pushtetit kanë ndikim të madh në sfidat e sigurisë, kërcënimet dhe rreziqet me të cilat përballemi. Asnjë vend nuk mund të përballë i vetëm me këto çështje. Prandaj, ne duhet të bashkëpunojmë në adresimin e kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave të përbashkëta dhe të punojmë drejt ofrimit të një përgjigjeje kolektive.

7. Shpeshtësia e fatkeqësive natyrore, fatkeqësive teknologjike, epidemive dhe ndryshimeve klimatike na prek të gjithëve. Asnjë vend në botë nuk është imun ndaj tyre, sepse ata nuk njohin kufij politikë.

8. Globalizimi dhe ndryshimet demografike kanë efekte pozitive dhe negative. Shtetet do të vazhdojnë të përballen me kërcënime tradicionale ushtarake në të ardhmen. Aktualisht, ata janë më të prekshëm ndaj kërcënimeve joushtarake, asimetrike, hibride dhe kibernetike dhe kërcënimeve nga aktorë joshtetërorë.

9. Hapja dhe bashkëpunimi ndërmjet shteteve, i kontribuon zhvillimit të përshpejtuar teknologjik dhe rritjes së shkëmbimit të informacionit ndërmjet të gjithë aktorëve të sigurisë në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Megjithatë, zhvillimi teknologjik në të njëjtën kohë lejon gjithashtu qasje më të madhe në teknologjinë moderne, me qëllim të dyfishtë që mund të përdoret për të kërcënuar sigurinë dhe stabilitetin.

10. Hapësira kibernetike ndikon dukshëm në sigurinë e njerëzve dhe shteteve. Edhe pse qasja globale, shkëmbimi i informacionit dhe përdorimi i internetit për qëllime biznesi dhe sociale kanë rezultuar të jenë vërtet të dobishme, ato përfaqësojnë gjithashtu kërcënim bashkëkohor për shoqërinë tonë për shkak të rritjes së cenueshmërisë së saj ndaj sulmeve kibernetike.

11. Bashkëpunimi dhe integrimi në zonën euro-atlantike ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e sigurisë dhe reduktimin e konflikteve. Ato karakterizohen nga përmirësimi i dukshëm i marrëdhënieve ndërmjet shteteve, me zhvillim demokratik dhe ekonomik, shtet ligjor dhe sistem të bazuar në vlerat e përbashkëta, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, bashkëpunimin e forcuar rajonal, si dhe kontributin e përbashkët për sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar. Pavarësisht kësaj, zona euroatlantike mbetet e ekspozuar ndaj një game të gjerë kërcënimesh, rreziqesh dhe sfidash.

### **Siguria rajonale në Europën Juglindore (SREJ)**

12. Shtetet e Europës Juglindore përballen me të njëjtat kërcënime ndaj paqes dhe sigurisë si shtetet e tjera në Europë. Turbulencat dhe mundësia e përhapjes së tyre në rajonet fqinje, mund të ndikojnë në gjendjen e përgjithshme politike, ekonomike dhe të sigurisë. Rajoni mbetet i rënduar nga historia e tij dhe vazhdon të përballlet me çështje të cilat mund t'i çojnë në paqëndrueshmëri.

13. Rrethi i sigurt ndërlikohet më tej nga prania e sasive të mëdha të armëve të paligjshme, si pasojë e konflikteve të mëparshme. Fluksi i emigrantëve dhe refugjatëve ekonomik ka potencialin të destabilizojë vendet e rajonit. Fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë tekniko-teknologjike, epidemitë dhe ndryshimet klimatike paraqesin rrezik shtesë për sigurinë.

14. Hyrja dhe transiti i emigrantëve dhe ekstremistëve radikalë dhe të kthyerve nga fushat e betejës së konflikteve në vendet e Lindjes së Mesme (Irak, Siri), Azinë Jugore (Afganistan) dhe Afrikën e Veriut (Libi), ndikojnë në situatën e sigurisë rajonale.

15. Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë kanë ndikim pozitiv në sigurinë në rajon. Shtetet në rajon janë të vetëdijshëm se bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë parakusht për ndërtimin e besimit të ndërsjellët, integrimin në strukturat europiane dhe euro-atlantike, përmirësimin e sigurisë rajonale, stabilitetit dhe rritjes ekonomike.

### **Republika e Maqedonisë së Veriut**

16. Rrethi i sigurt në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është përmirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit. Ne kemi krijuar marrëdhënie të mira me fqinjët tanë, shumica e të cilëve janë anëtarë të NATO-s ose BE-së, kanë agjendë euroatlantike, ose mbajnë marrëdhënie konstruktive me të dyja organizatat. Ne do të vazhdojmë të investojmë vazhdimisht në sigurinë dhe stabilitetin euro-atlantik,

duke ndërtuar kapacitetet tona mbi parimin e solidaritetit, marrëdhënie të fortë transatlantike dhe ndarjen e duhur të përgjegjësisë.

17. Republika e Maqedonisë së Veriut e sheh anëtarësimin e plotë të të gjitha vendeve të rajonit në NATO ose në BE, si mënyrën më të mirë për përmirësimin dhe konsolidimin e mëtutjeshëm të situatës së sigurisë në rajonin e Europës Juglindore dhe më gjerë.

18. Edhe pse ndryshojnë për nga kompleksiteti për të zbuluar, parandaluar dhe intensiteti i pasojave, kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë kombëtare mbivendosen dhe plotësojnë njëra tjetrën. Të njëjtat ndikojnë drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare dhe kërkojnë zhvillimin e politikave të duhura, aftësive dhe kapaciteteve të përshtatshme për t'u përballur me to:

- Problemet ekonomike dhe politike: Problemet e gjata të rritjes së pamjaftueshme ekonomike, korrupsionit, krimit të organizuar, kapaciteteve të pamjaftueshme të ndërtuara të institucioneve, papunësisë, dobësive në sistemin gjyqësor dhe politizimit të institucioneve demokratike mbeten sfida më e madhe e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjenerator kryesor i paqëndrueshmërisë në formën e sfidave sociale. Siguria energjetike është shqetësim shtesë duke pasur parasysh varësinë tonë në burimet e jashtme.
- Krimi i organizuar: Krimi i organizuar manifestohet kryesisht nëpërmjet tregtisë së paligjshme të drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Siguria e përgjithshme në rajon kërcënohet më tej nga prania e armëve dhe municioneve të paligjshme, të cilat mund të bëhen të disponueshme për grupet kriminale dhe ekstremiste.
- Shërbimet e huaja të inteligjencës: Veprimi i tyre i fshehtë është kërcënim serioz për sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i tyre është të vonojnë ose parandalojnë përpjekjet tona për t'u integruar në komunitetin euro-atlantik, veçanërisht për arritjen e anëtarësimin të plotë në NATO dhe në BE. Veprimi i tyre synon të sfidojë dhe të dobësojë përcaktimet politike dhe të sigurisë dhe potencialet ekonomike të shtetit dhe gërryerjen e kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes.
- Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm: Në të gjitha format e tij (kombëtare, politike dhe fetare), në raste të caktuara buron nga kontradiktat dhe mosmarrëveshjet historike, dhe amplifikohet nga zhvillimi i ngadaltë social dhe ekonomik i rajonit. Aktorët e huaj joshetërorë të krijuar, mund t'i shfrytëzojnë këto dobësi për të shkaktuar mosmarrëveshje dhe konflikte të brendshme ndëretnike.

- Terrorizmi: Terrorizmi mbetet kërcënim i vazhdueshëm për sigurinë kombëtare. Terrorizmi modern karakterizohet nga një lidhje e ngushtë me ekstremizmin e dhunshëm, veçanërisht me ekstremizmin fetar. Republika e Maqedonisë së Veriut është e ndjeshme ndaj sulmeve terroriste, por ka më shumë gjasa të përdoret si korridor për infiltrimin e terroristëve në Europën Perëndimore.
- Migrimi i paligjshëm: Migrimi i paligjshëm, i cili është kryesisht rezultat i konflikteve në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, por në të njëjtën kohë i udhëhequr nga logjika e thjeshtë ekonomike, nuk është kërcënim i drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare, por mund të rëndojë seriozisht një sërë institucionesh shtetërore dhe të angazhojë kapacitete të rëndësishme të shtetit në afat të mesëm dhe afatgjatë. Ky rrezik varet nga dinamika e ardhshme e migrimit dhe reagimit të konsoliduar ndaj tij.
- Kibernetike: Sulmet kibernetike dhe rrezikimi i sigurisë së informacionit janë sfida e vazhdueshme dhe në rritje të sigurisë globale. Pasojat më serioze të mundshme të sulmeve kibernetike janë rrezikimi i funksionimit të infrastrukturës kritike, përfshirë atë të sistemit të sigurisë dhe të sistemit të mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Fatkeqësitë elementare, katastrofat teknike dhe teknologjike, epidemitë dhe ndryshimet klimatike janë kërcënime indirekte / të tërthorta që janë të vështira për t'u parashikuar dhe mund të kenë implikime serioze për sigurinë dhe institucionet e tjera shtetërore. Degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit është i lidhur ngushtë me ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale. Ajo që thuhet në të ardhmen do të jetë një nga problemet më të rëndësishme dhe do të përbëjë rrezik sigurie në planin afatgjatë, gjë që mund të ndikojë indirekt në sistemin e mbrojtjes.

### III. KËRCËNIMET, RREZIQET DHE SFIDAT E MBROJTJES

19. Megjithëse mjedisi i sigurisë rajonale është përmirësuar ndjeshëm në periudhën e kaluar, marrëdhëniet në Ballkan vazhdojnë të jenë të ndjeshme. Dallimet e natyrës kombëtare, etno-fetare dhe kulturore dhe qëllimet dhe interesat kontradiktore mund të jenë sfida e sigurisë dhe sigurisë së rajonit.

20. Probabiliteti i agresionit të armatosur si kërcënim i drejtpërdrejtë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është minimal. Nga përvoja e dy dekadave të fundit, më real është kërcënimi indirekt. Rreziqet më të rëndësishme me të cilat përballemi vijnë nga kërcënimet asimetrike, hibride, kibernetike dhe kërcënime të tjera të një natyre jo-ushtarake, përfshirë ato nga aktorët jo-shtetërorë, fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë teknologjike, epidemitë dhe ndryshimet klimatike.

21. Në lidhje me sfidat, kërcënimet dhe rreziqet e identifikuara të sigurisë, sistemi i mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të ndërtojë kapacitete dhe aftësi për t'iu përgjigjur atyre: në kushte të situatave ushtarake dhe të krizës, kërcënimeve kibernetike dhe hibride, terrorizmit, aktiviteteve të aktorëve të huaj dhe jo-shtetërorë, kërcënimeve ndaj infrastrukturës kritike dhe trafikimit të paligjshëm të armëve konvencionale, armëve të shkatërrimit në masë dhe teknologjisë bërthamore.

#### IV. POLITIKA E MBROJTJES

##### **Përcaktimet themelore**

22. Politika moderne dhe relevante e mbrojtjes ka rëndësi thelbësore për realizimin e interesave të përhershme jetësore. Kjo përfshin një sërë masash dhe aktiviteteve që synojnë përgatitjen efikase të të gjithë sistemit të mbrojtjes, si segment i sistemit të sigurisë kombëtare për arritjen e qëllimeve të mbrojtjes dhe është përgjigje ndaj kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave ekzistuese dhe të ardhshme ndaj mbrojtjes kombëtare.

23. Qëllimet e politikës së mbrojtjes realizohen nëpërmjet menaxhimit efektiv të sistemit dhe zhvillimit të aftësive të nevojshme sipas burimeve të disponueshme. Procesi i përcaktimit të politikës së mbrojtjes, përfshin monitorimin e vazhdueshëm të dinamikës së mjedisit strategjik të sigurisë dhe përshtatjen e vazhdueshme të sistemit për trajtimin e situatave në zhvillim.

24. Një qasje e tillë nënkupton koordinimin dhe bashkëpunimin më intensiv ndërsektorial dhe ndërinstytucional në përgatitjen dhe zbatimin e politikës së mbrojtjes.

25. Politika e mbrojtjes merr në konsideratë parimet thelbësore të paprekshmërisë së kufijve, fqinjësisë së mirë, kohezionit social dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së vetëmbrojtjes. Konceptet e mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese zënë vend qendror së bashku me parimin bazë të promovimit të sigurisë, paqes dhe stabilitetit. Të gjitha proceset e politikës së mbrojtjes do të përqëndrohen te qytetari, si bartës kryesor i mbrojtjes së shtetit.

26. Zgjidhjet e mbrojtjes nuk paraqesin vetëm grup aftësish ushtarak, por përfshijnë edhe përpjekjet politike, menaxhimin e komponentëve dhe kapaciteteve kombëtare ekonomiko-energjetike dhe teknologjike të mbrojtjes së mjedisit njerëzor.

27. Përcaktimi strategjik i integritimit europian dhe euro-atlantik dhe anëtarësimi në sistemet kolektive të mbrojtjes dhe sigurisë, mbeten prioriteti kryesor i politikës sonë të mbrojtjes, fokusi i së cilës është anëtarësimi në NATO dhe në BE. Republika e Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të punojë në bashkëpunim të gjithanshëm në fushën e mbrojtjes me fqinjët e saj, vendet e rajonit dhe me vendet partnere, për realizimin e interesave tona të përbashkëta.

28. Në këtë kontekst, Republika e Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të kontribuojë në ruajtjen e sigurisë dhe paqes në botë dhe në rajon, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në operacionet e mbështetjes së paqes, operacionet e menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese. Plotësisht do t'i përkushtohet përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare dhe zbatimit të marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare.

29. Qasja jonë gjithëpërfshirëse ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar do të pasqyrohet gjithashtu nëpërmjet diplomacisë aktive të mbrojtjes, mbrojtjes dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe bashkëpunimit ushtarak bazuar në parimet e “Pooling&Sharing” dhe “Smart Defence”.

### **Interesat e mbrojtjes**

30. Interesat e mbrojtjes rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga Koncepti Kombëtar i Sigurisë dhe i Mbrojtjes.

31. Interesat themelore të mbrojtjes nga të cilat rrjedhin qëllimet e mbrojtjes janë:

- mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial dhe pacenueshmërisë së kufijve të shtetit të njohur ndërkombëtarisht;
- sigurimi i objekteve mbrojtëse me qëllim që mbrojtja kombëtare të garantojë sigurinë dhe realizimin e lirive të qytetarëve;
- integrimi euro-atlantik, duke përfshirë anëtarësimin e plotë në NATO dhe në BE dhe pjesëmarrjen në aranzhimet e përshtatshme bashkëpunuese dhe kolektive të mbrojtjes dhe sigurisë;
- vendosja e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, europë dhe në botë; përkrahja e institucioneve civile në situata dhe kushte të ndryshme krize

### **Qëllimet mbrojtëse**

32. Interesat e mbrojtjes do të realizohen duke arritur qëllimet e mëposhtme të mbrojtjes:

- mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për të arritur këtë qëllim, ne do të angazhojmë të gjitha kapacitetet dhe pjesëmarrësit në sistemin e mbrojtjes nëpërmjet një plani të koordinuar mbrojtës që do t'i përfshijë aftësitë e parandalimit, rezistencës dhe mbrojtjes. Do të ndërtojmë qasje pro aktive në menaxhimin e procesit të

planifikimit dhe efikasitetit në ekzekutimin e politikës së mbrojtjes, duke krijuar procese gjithëpërfshirëse të planifikimit dhe procedura zbatimi që do të sigurojnë analizë të vazhdueshme të mjedisit të sigurisë dhe interesave të mbrojtjes, në përputhje me procesin e planifikimit të mbrojtjes të NATO-s dhe zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të përshtatshme;

- gatishmërinë e kapaciteteve dhe aftësive mbrojtëse. Ne do të trajnojmë dhe mbajmë kapacitete dhe aftësi mbrojtëse shumë të përgatitura, në të gjitha fushat, për t'u përballur në mënyrë efektive me kërcënimet, rreziqet dhe sfidat. Të njëjtët do të karakterizohen nga fleksibiliteti, vendosshmëria dhe ndërveprueshmëria. Për arritjen e këtij qëllimi, ne do t'i menaxhojmë në mënyrë efikase dhe do t'i përdorim në mënyrë racionale burimet e disponueshme në zbatimin e politikës së mbrojtjes, me theks në llogaridhënien, transparencën dhe zero tolerancën ndaj korrupsionit.
- forcimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe anëtarësimin në sistemet e sigurisë kolektive. Për arritjen e këtij qëllimi ne do të krijojmë partneritete të reja, do t'i forcojmë ato ekzistuese dhe do ta ndajmë barrën në përputhje me rrethanat në kuadër të mbrojtjes bashkëpunuese. Pas anëtarësimit të plotë në NATO dhe në BE, ne do të marrim pjesë plotësisht në mbrojtjen kolektive dhe në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS).
- kontributin në përpjekjet ndërkombëtare për të ndërtuar dhe ruajtur paqen. Do të zhvillojmë forca dhe aftësi për të marrë pjesë në operacione dhe misione ndërkombëtare për të mbështetur paqen dhe sigurinë e projekteve, në përputhje me interesat e sigurisë kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare.
- trajtimin efikas të fatkeqësive natyrore, fatkeqësive tekniko-teknologjike, epidemive dhe ndryshimeve klimatike. Me planifikim gjithëpërfshirës, do të ofrojmë kapacitete për parandalim dhe për reagim të përshtatshëm kombëtar në situata emergjente dhe krize, në mbështetje të institucioneve civile. Do të sigurojmë gjithë përfshirje në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të shtetit nëpërmjet bashkëpunimit të koordinuar ndër-institucional me institucionet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare dhe bashkimin e forcave dhe ekspertizës për t'iu përgjigjur sfidave bashkëkohore;
- ndërtimi i kapaciteteve mbrojtëse të cilat do të mundësojnë efektivitet më të madh të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, (Armata) dhe do të zvogëlojnë ndikimin në mjedis;
- rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë të rolit dhe rëndësisë së sistemit të mbrojtjes për sigurinë e vendit, si dhe për nxitjen e kohezionit kombëtar dhe social. Për të siguruar mbështetjen publike për mbrojtjen dhe për të rritur

interesin për t'u bashkuar me ushtrinë, ne do të promovojmë rëndësinë e qëllimeve, misioneve dhe aktiviteteve të ushtrisë dhe mbrojtjes në tërësi.

33. Qëllimet e mbrojtjes janë baza e planifikimit të mbrojtjes dhe koordinimit të nevojshëm, nga ku kryhen dhe detajohen detyrat e të gjitha subjekteve në sistem, të përgatitjes së reagimit mbrojtës në kushte paqeje, lufte, krize ose emergjence.

## V. SISTEMI I MBROJTJES

34. Sistemi mbrojtës i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i fokusuar në ushtrimin efikas dhe efektiv të funksionit kushtetues të mbrojtjes dhe mbrojtjes së vendit nga të gjitha llojet e kërcënimeve të jashtme/të brendshme. Në të njëjtën kohë, sistemi synon arritjen e nivelit të nevojshëm të elasticitetit, fleksibilitetit dhe ndërveprueshmërisë brenda kuadrit të mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese.

35. Sistemi i mbrojtjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga:

- komponenti ushtarak - bartësi kryesor i të cilit janë forcat e armatosura, përkatësisht Ushtria dhe

-komponenti jo ushtarak – i përbërë nga institucionet e tjera shtetërore të cilët kanë interes në trajtimin e kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë, organet e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, kompanitë dhe qytetarët, të përcaktuara me Ligjin e Mbrojtjes.

36. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme mbrojtëse, kërkon qasje gjithëpërfshirëse të të gjitha subjekteve të sistemit dhe duhet të pasqyrojë në mënyrë adekuate shpejtësinë e ndryshimeve të kërcënimit.

### **Komponenti ushtarak**

37. Sfidat bashkëkohore të sigurtas, si dhe burimet e disponueshme të shtetit, do ta përcaktojnë nevojën e aftësive mbrojtëse minimale dhe optimale për zhvillimin e një strukture efektive dhe të qëndrueshme të ushtrisë, të nevojshme për kryerjen e misioneve dhe detyrave të caktuara.

38. Ushtria do të zhvillojë dhe do të mbajë aftësitë e duhura të përmbushjes efektive të qëllimeve dhe objektivave të saj. Do t'i jepet përparësi zhvillimit të aftësive operationale në mbështetje të interesave kombëtare dhe objektivave të

sigurisë kombëtare, duke përfshirë aftësitë për të mbështetur autoritetet civile kombëtare.

39. Aftësitë kombëtare të mbrojtjes do të bazohen në fushën tokësore, ajrore dhe kibernetike, të mundësuar dhe të mbështetura nga elementët kryesorë operacional që përfshijnë komandën dhe kontrollin, personelin, infrastrukturën, logjistikën, inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin, mbështetjen mjekësore, sistemet e komunikimit dhe informacionit si dhe trajnimin.

40. Qasja gjithëpërfshirëse do të bazohet në aftësitë e përcaktuara qartë të komandës dhe kontrollit (K2), të cilat do të përmirësohen vazhdimisht për të siguruar efektivitetin dhe ndërveprueshmërinë e sistemit. Si mbështetje, do të zhvillohet aftësi e integruar për parashikueshmërinë në kohë dhe të përditësuar të ecurisë dhe zhvillimit e rreziqeve dhe kërcënimeve në të gjitha nivelet e operacioneve.

41. Forcat tokësore shumë funksional me shumë qëllime të mbështetura dhe të siguruar në mënyrë adekuate, do të jenë forca kryesore e komponentit ushtarak të sistemit. Dimensionaliteti i tyre me shumë qëllime do të reflektohet nëpërmjet manovrimit të lehtë dhe vendosjes së shpejtë dhe rritjes të qëndrueshmërisë së tyre.

42. Këto aftësi, do të zhvillohen dhe strukturohen si task forcë lehtësisht të adaptueshme, të cilat do të mundësojnë ekzekutimin e aktiviteteve brenda spektrit të plotë të operacioneve.

43. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e forcave të nevojshme të operacioneve speciale si kapacitet i forcave tokësore shumë funksional do të mundësojë arritjen e ekonomisë së lartë të mbrojtjes dhe do të maksimizojë efektin e komponentit ushtarak.

44. Aftësitë e aviacionit do të dimensionohen në mënyrë adekuate për të siguruar mbështetjen e nevojshme ajrore të forcave me qëllime shumë funksionale, por edhe për të mbështetur autoritetet civile në situata dhe kushte të ndryshme krize.

45. Me integrimin e aftësive kombëtare të aviacionit, do të arrijmë efikasitet në menaxhim dhe ekonomi në zhvillim, ku bashkëpunimi ndërinstucional duhet të jetë imperativ të përdorimit efektiv të tyre. Burimet e kufizuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për monitorimin e trendëve bashkëkohore në aviacion tregojnë maksimizimin e bashkëpunimit intensiv rajonal të mbrojtjes me vendet e Europës Juglindore dhe në kuadër të integritimeve euroatlantike.

46. Ushtria do të zhvillojë forca rezervë, të përbërë nga komponent aktiv dhe i përgjithshëm, strukturat dhe aftësitë e të cilave do të përcaktohen sipas nevojave të mbështetjes së forcave të armatosura.

47. Ne do të mbështesim paqen, sigurinë, stabilitetin rajonal dhe ndërkombëtar, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në operacionet dhe misionet e udhëhequra në NATO dhe në BE, si dhe operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare, humanitare dhe vëzhguese të udhëhequra nga OKB-ja dhe OSBE-ja dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në forma të ndryshme të bashkëpunimit ushtarak në nivele dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe. Ushtria do të mbajë kapacitetet dhe aftësitë e dislokueshme ushtarake të pajtueshme dhe të ndërveprueshme në pajtim me kodin e aftësive dhe aftësive të NATO-s.

48. Për të kontribuar në të gjithë spektrin e operacioneve dhe misioneve të udhëhequra nga NATO, Republika e Maqedonisë së Veriut do të zhvillojë dhe mbajë aftësi të dislokueshme në nivelin e 50% të strukturës së përgjithshme të forcave tokësore shumë funksionale. Në planin afatgjatë, do të marrim pjesë njëkohësisht në operacionet ndërkombëtare me njësi dhe personelin ushtarak të cilët gradualisht do të rriten në 10% të strukturës së përgjithshme të Ushtrisë, në përputhje me dinamikën e zhvillimit të aftësive të dislokueshme.

49. Forma më e lartë e organizimit të forcave tokësore shumë funksionale për pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare do të jetë grup i batalionit të lehtë të këmbësorisë, me aftësi të zhvilluara për vendosjen dhe veprimin e pavarur në pjesë të spektrit të operacioneve dhe misioneve të NATO-s, si dhe përfshirjen në formacione më të larta shumëkombëshe.

50. Pjesë e aftësive të kërkuara të grupit të batalionit të këmbësorisë së lehtë, të nevojshme për kryerjen e misioneve specifike në operacionet të udhëhequra nga NATO që ushtria nuk do t'i zhvillojë, do të sigurohen në bashkëpunim me forcat aleate të dislokuara në operacione.

51. Në funksion të sistemit do të zhvillohen aftësi për ndihmë, trajnim, përballje me efektet e fatkeqësive humanitare, mbrojtje kibernetike, ndërveprim civil-ushtarak, si dhe diplomaci ushtarak.

52. 48. Në kushtet kur institucionet kompetente shtetërore (përfshirë dhe vetëqeverisjen lokale), nuk mund t'i përballojnë krizat, përkatësisht kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme, kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike, fatkeqësive natyrore, fatkeqësive teknologjike, epidemive dhe ndryshimeve klimatike, si dhe kur kërcënojnë kufijtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ushtria do të ofrojë

mbështetje për komponentin civil të sistemit të mbrojtjes, si dhe për policinë në përputhje me procedurat e përcaktuara.

53. Në parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, do të fokusohemi në konsolidimin, koordinimin dhe arritjen e bashkëpunimit më të ngushtë midis të gjithë elementëve të komunitetit kombëtar të inteligjencës.

54. Në fushën e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, do të vazhdojmë të përmirësojmë kapacitetet dhe aftësitë ekzistuese. Në afat të mesëm dhe afatgjatë, do të investojmë në ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të reja të sigurisë së informacionit/sigurisë së informacionit dhe parandalimin e sulmeve kibernetike. Nëpërmjet zhvillimit të aftësive të luftës elektronike dhe mbrojtjes kibernetike, do të sigurohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit dhe e rrjeteve. Zhvillimi i këtyre aftësive duhet të jetë i sinkronizuar dhe i koordinuar në nivel kombëtar.

55. 51. Zhvillimi afatgjatë i aftësive mbrojtëse do të realizohet nëpërmjet vlerësimit dhe dhënies së prioritetit të aftësive ekzistuese dhe të nevojshme në përputhje me burimet në dispozicion, në mënyrë që të minimizohet rreziku drejtë mbrojtjes kombëtare.

56. Mbështetja në zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive mbrojtëse do të kërkojë sigurimin e burimeve të përshtatshme njerëzore, materiale dhe financiare, si dhe infrastrukturë adekuate.

### **Komponenti joushtarak**

57. Aktivitetet e subjekteve të komponentit civil në aspektin e angazhimit të tyre në mbështetje të sistemit të mbrojtjes, do të koordinohen nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Komponenti jo ushtarak i sistemit të mbrojtjes duhet të sigurojë kushte të funksionimit të tij, si dhe të mbështetjes së forcave kombëtare dhe aleate në kushte krize.

58. Në segmentin e menaxhimit të krizave, do të angazhojmë burime për përmirësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive për paralajmërim të hershëm, shqetësim, koordinim dhe veprim në rast krize apo situatë krize.

59. Në kuadër të komponentit jo ushtarak të sistemit të mbrojtjes, do të ndërtojmë kapacitete civile për sigurimin e mbështetjen e vendit pritës, mbështetjen mjekësore, kapacitete të komunikimit dhe sigurisë së informacionit, si dhe mbështetjen me ekspertë civilë nga specialitete të ndryshme.

60. Sektori i mbrojtjes njih sfidat, nevojën dhe përpjekjet për të mbrojtur mjedisin. Do të ndërtojmë kapacitete me synim uljen e efekteve të veprimeve ushtarake, eliminimin e efekteve negative në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, si dhe përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave të sigurisë dhe ndikimit të tyre negativ në mjedis. Para dhe gjatë aktiviteteve trajnuese, në bashkëpunim me komponentin civil, do të sigurojmë kontroll të vazhdueshëm me qëllim parandalimin e pasojave të dëmshme për mjedisin, qytetarët dhe shëndetin e tyre.

61. Do të punojmë me zell për të rritur ndërgjegjësimin e personelit ushtarak për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zhvillimit të politikave të duhura, akteve të standardizimit dhe udhëzimeve të mbrojtjes së mjedisit gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve stërvitore. Si anëtare e NATO-s do të fokusohemi në përfshirjen aktive në aktivitetet kombëtare, si dhe në punën e NATO-s në këtë fushë. Do të mbështesim projektet e promovuar nga programi i NATO-s – Shkenca për Paqe dhe Siguri, në fushën e mbrojtjes së sigurisë së mjedisit.

62. Dimensionimi i sistemit të mbrojtjes në afat të mesëm dhe afatgjatë, do të udhëhiqet nga nevoja për të ndërtuar aftësinë, për t'u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e sigurisë, bazuar në vlerësimin e kërcënimeve dhe rreziqeve, nevojave kombëtare dhe përshtatjen e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme në përputhje me burimet e disponueshme.

## VI. BURIMET DHE AFTËSITË E MBROJTJES

63. Burimet e mbrojtjes përfshijnë mjetet njerëzore, materiale dhe financiare që do të vihen në dispozicion kombëtar mbrojtës dhe nga të cilat do të varet arritja e qëllimeve të mbrojtjes.

64. Zhvillimi racional dhe efektiv, mirëmbajtja dhe përdorimi i aftësive të mbrojtjes, do të forcohet nga zbatimi i sistemit të planifikimit, programimit, buxhetit dhe ekzekutimit (SPPPBI) në mbrojtje. Prioritetizimi, autorizimi dhe angazhimi i burimeve do të mundësojnë përgjegjshmëri dhe transparencë më të mirë të subjekteve në proceset e menaxhimit të mbrojtjes dhe ofrimin e mbështetjes në largimin e korrupsionit nga sistemi.

65. Aftësitë e mbrojtjes do të ridizajnohen në mënyrë që të zvogëlohet gradualisht personeli dhe të zëvendësohen pajisjet e vjetruara me pajisje moderne dhe bashkëkohore, të përputhshme me vendet anëtare të NATO-s dhe të BE-së. Duke vepruar kështu, do t'i përmirësojmë aftësitë ekzistuese dhe do të ofrojmë kushte për integrim dhe kontribut të përshtatshëm të sistemit të mbrojtjes kombëtare në mbrojtjen kolektive të aleancës.

66. Riorganizimi dhe zhvillimi i sistemit të mbrojtjes, do të përfshijë krijimin e një hierarkie dokumentesh strategjik, krijimin e kuadrit ligjor të përshtatshëm dhe ri përcaktimin e subjekteve të sistemit dhe kompetencave të tyre. Në këtë mënyrë do të shmanget dyfishimi i detyrave, do të arrihet koordinim më i mirë ndërmjet komponentëve ushtarak dhe civil dhe do të garantohet përdorimi sa më efikas dhe racional i burimeve.

67. Duke maksimizuar përdorimin e kapaciteteve të dedikuara vendase dhe njohuritë dhe përvojën e tyre, do të nxitet drejtpërdrejtë lidhja simbiotike e sistemit me ekonominë kombëtare dhe përfshirja e ekonomisë kombëtare në proceset e zhvillimit dhe mbajtjes së aftësive të nevojshme mbrojtëse.

### Burimet njerëzore

68. Tërheqja konkurruese dhe përzgjedhja e individëve me motivim të lartë do të jetë qëllimi i politikës së mbrojtjes personale. Në këtë drejtim janë të nevojshme reformat e sistemit të pagave, përfitimeve dhe shpërblimeve, për ta bërë shërbimin në mbrojtje dhe shërbimin ushtarak më tërheqës, në raport me sektorët e tjerë në shoqëri dhe më gjerë.

69. Segmentin e edukimit dhe trajnimit do ta riorganizojmë për nevojat e sistemit të mbrojtjes sipas nevojave, përvojave, mësimëve të nxjerra dhe nevojave institucionale.

70. Politika e mbrojtjes, do të pasqyrojë njëkohësisht profesionalizmin dhe përfaqësimin e duhur e të drejtë të komuniteteve. Zbatimi i parimit të perspektivës gjinore do të përfshihet në të gjitha fazat e politikës dhe planifikimit të mbrojtjes. Në këtë mënyrë, do të sigurohet personel i kualifikuar civil dhe ushtarak, i cili me udhëzime të planifikuara në karrierë dhe edukim dhe trajnim të përshtatshëm, do të jetë në gjendje të realizojë interesat kombëtare të mbrojtjes dhe detyrimet ndërkombëtare për t'u përballur me sukses me sfidat e sigurisë në të ardhmen.

71. Njëkohësisht me integrimin e menaxhimit të njohurive, përmirësimin e kushteve të punës dhe disiplinave dhe teknologjive të tjera bashkëkohore, në proceset e punës së mbrojtjes, burimet njerëzore ekzistuese dhe ato të ardhshme do të përdoren në mënyrë racionale.

## **Burimet materiale**

72. Statusi aktual i pajisjeve dhe i mjeteve materiale dhe teknike në dispozicion të ushtrisë kërkojnë zëvendësimin e duhur të tyre me pajisje të reja më të sofistikuar në përputhje me standardet e NATO-s.

73. Me automatizimin dhe thjeshtimin e proceseve të menaxhimit të burimeve materiale, veçanërisht në fushën e blerjes dhe mirëmbajtjes, do të sigurohet përdorimi në kohë, transparent dhe i duhur i burimeve materiale në mbrojtje.

74. Plani afatgjatë i Zhvillimit të Aftësive Mbrojtëse dhe Plani i Pajisjeve dhe i Modernizimit, do të përcaktohen mbi prioritete të përcaktuara qartë dhe në kornizë kohore për zbatimin e tyre, në përputhje me burimet e disponueshme.

## **Infrastruktura**

75. Republika e Maqedonisë së Veriut, ka një infrastrukturë të konsiderueshme të mbrojtjes që i tejkalon nevojat aktuale të mbrojtjes.

76. Me konsolidimin e komandave dhe njësisve të ushtrisë në një numër më të vogël vendesh në kohë paqeje dhe duke asgjësuar objektet dhe pronat e tepërta infrastrukturore në dispozicion të mbrojtjes, do të sigurohen burime financiare

shtesë për rinovimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së re dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës së personelit në mbrojtje dhe në ushtri.

77. Me identifikimin dhe prioritizimin e saktë të infrastrukturës kritike, do të sigurohet mbrojtje më efikase e tyre në përputhje me interesat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare të vendosura.

### **Burimet financiare**

78. Financimi i qëndrueshëm i mbrojtjes, është parakusht kryesor për zhvillimin e aftësive të nevojshme mbrojtëse. Burimet financiare të mbrojtjes para së gjithash do të sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa për arritjen e qëllimeve të mbrojtjes kolektive, mund të realizohen kapacitete të caktuara në përputhje me marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura më parë.

79. Republika e Maqedonisë së Veriut, duhet të sigurojë buxhet të qëndrueshëm shumëvjeçar të mbrojtjes në nivelin 2% të prodhimit të brendshëm bruto, si parakusht i domosdoshëm i planifikimit efikas afatgjatë të mbrojtjes, zhvillimin e aftësive të reja dhe modernizimin e forcave.

80. Duke ndarë fondet e buxhetit të mbrojtjes deri në 50% për kostot e personelit, duke rritur kostot e operacioneve, mirëmbajtjes dhe trajnimit deri në 30% dhe duke ruajtur kostot e pajisjeve dhe modernizimit të paktën 20%, do të arrijmë shfrytëzimin optimal të fondeve të cilat në afat të gjatë do të mundësojnë arritjen e qëllimeve të mbrojtjes dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja të nevojshme të përballimit së sfidave të reja të sigurisë.

## VII. ZBATIMI

81. Zbatimi i Strategjisë së Mbrojtjes, kërkon vendosjen e nivelit të përshtatshëm të koordinimit ndërmjet subjekteve të komponentit ushtarak dhe atij civil të sistemit dhe është parakusht bazë i efikasitetit në trajtimin e kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë.
82. Për realizimin e qëllimeve të mbrojtjes, është e nevojshme edhe mbështetja e plotë politike nga të gjitha subjektet politike, si dhe mbështetja e gjerë nga qytetarët e shtetit.

## VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

83. Në ditën e publikimit të kësaj strategjie, shfuqizohet Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 30/10).
84. Kjo strategji është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetari  
i Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Stevo Pendarovski